



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



**Njësia e Prokurimit**

Gjakovë, datë 19.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.08.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Eng Geo Group” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i sheshit Dëshmorët e Ponoshecit”, Nr. i prokurimit- 632-26-4197-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-024-5-2-1, nxjerr:

**V E N D I M**

**1. APROVOHET SI PJESËRISHT E BAZUAR** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “Eng Geo Group” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Rregullimi i sheshit “Dëshmorët e Ponoshecit”, Nr. i prokurimit- 632-26-4197-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-024-5-2-1,, kundër **NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, të publikuar me datë 13.08.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

**2. ANULOHET NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, i publikuar me datë: 13.08.2026.

**3.**Autoriteti Kontraktues, vendos që ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik “Eng Geo Group” SH.P.K., me dt.18.08.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi i sheshit Dëshmorët e Ponoshecit”, me Nr. të prokurimit- 632-26-4197-5-2-1, dhe Nr. të brendshëm 632-26-024-521.

Autoriteti Kontraktues-Komuna e Gjakovës, me datë 19.08.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar se:

Pretendimet tuaja janë pjesërisht të bazuara. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues do ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Kopje:**

*Operatorit Ekonomik;*

*Zyrës së Kryetarit të Komunës;*

*Të gjitha palëve të interesuara;*

**FATON GUTAJ**  
  
*Menaxher i Zyrës së Prokurimit*

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi